



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30 dhjetor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_3015_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nën par. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike, të dorëzuar me datë 23 korrik 2025, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues,

në seancën e mbajtur me datë 30 dhjetor 2025, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (në tekstin e mëtejme: MAR) në vlerën 964,160€ për ndërmarrjen NQ Gjakova SH.A., që do të mblidhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2025/2026.**
- II. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Gjakova SH.A., duke filluar nga data e aprovimit deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.**

A R S Y E T I M

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 23 korrik 2025 nga NQ Gjakova SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që ndërmarrjes i lejohet të mbledhë nga tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR), ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, të datës 23 korrik 2025;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 12 gusht 2025, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur;
 - Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Gjakova SH.A. me datë 22 gusht 2025;




- Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Gjakova SH.A.– sezoni i ngrohjes 2025/2026;
 - Gjatë periudhës së konsultimit publik (15 – 29 dhjetor 2025) ZRRE nuk ka pranuar ndonjë koment për raportin në fjalë;
 - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Gjakova SH.A. – sezoni i ngrohjes 2025/2026.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Bashkangjitur: Raporti Rregullativ: Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara për NP Gjakova sh.a. – sezoni i ngrohjes 2025/2026

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së